

Vendim nr. 31 datë 29.05.2023

(V-31/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Elsa Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 20.04.2023 dhe 26.05.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 16 (Sh) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SHPRESA KEKEZI, TERI KEKEZI, BLEDAR LASKU, DONIKA SHKURTI, ROLAND SHKURTI, LEANDRO SHKURTI

SUBJEKT I INTERESUAR:

SHOQËRIA “MURATAJ” SH.P.K., REZARTA NGJELA (KEKEZI), VERONIKA SHANI, MERI KONOMI, ALEKSANDRA LASKU, KOSTANDIN LASKU, INGRID LASKU, JANI SHKURTI, DHIMITËR SHKURTI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2139, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afateve të arsyeshme të gjykimit në procedurën e zgjidhur deri më sot me vendimin nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Urdhërimi për kryerjen e pagesave sipas këtij vendimi.

Rivendosja e së drejtës së pronësisë për shpronësimin e pësuar nga kërkuesit.

Shpërblimi i kërkuesve për shkeljen e afateve të arsyeshme të gjykimeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27 dhe 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, shoqërisë “Murataj” sh.p.k., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë të Kostandin Laskut, ish – pronar i një trualli të ndodhur në Tiranë, në rrugën “Muhamet Gjollesha”, të njohur me vendimin nr. 499, datë 21.03.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*), Tiranë. Me vendimet nr. 562, datë 20.05.1996, nr. 705, datë 30.09.1996 dhe nr. 170, datë 30.09.1997 të *KKKP*-së, Tiranë është vendosur kompensimi fizik i trashëgimtarëve me sipërfaqe trualli respektivisht 270 m², 460 m² dhe 340 m², në total me sipërfaqen 1070 m².

2. Mes trashëgimtarëve Lasku dhe shoqërisë “Murataj” sh.p.k. është lidhur një marrëveshje në formën e shoqërisë së thjeshtë, e palegalizuar me shkrim, përmes së cilës është rënë dakord që shoqëria të ndërtojë në truallin prej 700 m², në pronësi të trashëgimtarëve Lasku, një pikë servisi, lavazhi dhe karburanti. Sipas kësaj marrëveshjeje, fitimet e realizuara nga veprimtaria tregtare do të ndaheshin në mënyrë të barabartë nga 50%. Me vendimin nr. 32, datë 12.10.1996 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë është dhënë leja e ndërtimit për këto objekte në emër të kërkuesve, ndërsa ndërtimi i objektit është bërë me shpenzimet e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. Pas ndërtimit të objektit është bërë regjistrimi i tij në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë (*ZVRPP*) me nr. 3714, datë 22.10.1998, në emër të kërkuesve (*vendimi nr. 3714/1998*).

3. Nga materialet e depozituara nga kërkuesit së bashku me kërkesën, si dhe nga të dhënat e nxjerra nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se çështja e pronësisë së objektit të ndërtuar, e trullit mbi të cilin është ndërtuar ai, si dhe e detyrimeve financiare të rrjedhura nga marrëveshja e lidhur mes palëve janë bërë objekt gjykimesh të ndryshme gjyqësore. Në kushtet kur proceset e ndryshme gjyqësore për këto çështje ndërthuren me njëri-tjetrin, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) vlerëson t'i paraqesë shkurtimisht në vijim.

- Procedurat për njohjen e pronësisë së ndërtimit dhe të trullit

4. Pasi është vënë në dijeni në fund të vitit 1998 për regjistrimin me vendimin nr. 3714/1998 të ZVRPP-së, Tiranë të ndërtimit të bërë në truallin e kërkuesve, si pronë e ndërtuar nga ata vetë, shoqëria “Murataj” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e kërkuesve ta njohin pronare të ndërtimit, pikë karburanti, servis, lavazh e bashkëpronare në pronësinë e paluajtshme në tërësi, si dhe regjistrimin e vendimit në ZVRPP-në, Tiranë, ndërsa kërkuesit kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. të kthejë sendin, pasuri e paluajtshme, te pronari i ligjshëm.

5. Me vendimin nr. 1280, datë 27.04.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë; detyrimin e trashëgimtarëve Lasku të njohin pronar të vetëm për pjesën e karburantit servisit dhe lavazhit dhe truallit të ndodhur nën të, shoqërinë “Murataj” sh.p.k; detyrimin e kësaj shoqërie t'u paguajë trashëgimtarëve Lasku shumën 53115\$ për sipërfaqen e tokës së zënë me objektin pikë karburanti, shumën 1348573 lekë si fitim i nxjerrë nga pika e karburantit deri në datën 17.04.2000 dhe vazhdimin e ecjes së fitimit deri në marrjen e formës së prerë të vendimit ; detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. të lidhë kontratë qiraje për pjesët 1/7-ën dhe 3/42-ën të tokës me të paditurit Eleni Shkurti dhe Krisanth Jaku në pjesë respektive; çregjistrimin nga regjistri i pasurive të paluajtshme të pikës së karburantit dhe të tokës në emër të trashëgimtarëve Lasku për pronën nr. 3714, datë 22.10.1998, përveç pjesëve 1/7-ta e tokës së Eleni Shkurtit dhe 3/42-at e tokës të Krisanth Jakut.

6. Me vendimin nr. 283, datë 13.03.2001, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 192, datë 15.02.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shoqëria “Murataj” sh.p.k. Në rigjykim, gjykata e rrethit, me vendimin nr. 640, datë 20.02.2003, ka vendosur pranimin e padisë; detyrimin e të paditurve Arsinoi Kekezi etj. të njohin shoqërinë “Murataj” sh.p.k., me ortakë Fatos Muratin e Viron Hamzain, pronare të

ndërtimit “pikë servisi, lavazhi e karburanti” dhe bashkëpronare në pasurinë e paluajtshme në tërësi, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 3712, datë 22.10.1998, sipas pjesëve takuese të secilës palë, pala paditëse objektin, pala e paditur truallin 700 m²; rrëzimin e kundërpadisë si të pambështetur në ligj e në prova; urdhërimin e ZVRPP-së, Tirana 1 të bëjë ndryshimet në regjistrin hipotekor nr. 3712, datë 22.10.1998. Gjykata ka vlerësuar se në sendin e krijuar njëra palë është pronare e truallit dhe tjetra e objektit dhe se të dyja palët janë bashkëpronare të sendit në tërësi, sipas pjesëve përkatëse në të, pjesë të cilat janë të bashkuara me njëra-tjetrën dhe nuk mund të ndahen pa iu shkaktuar atij një dëm thelbësor, për rrjedhojë, në kushtet e një bashkëpronësie të detyrueshme, palët kanë njëllloj të drejta të përfitojnë nga kjo bashkëpronësi *(shih vendimin nr. 640, datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqja 4)*. Vendimi i gjykatës së rrethit është lënë në fuqi me vendimin nr. 823, datë 23.06.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Ndaj rekursit të paraqitur nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 823, datë 23.06.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë për sa i përket kundërpadisë, prishjen e vendimit nr. 640, datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes lidhur me padinë. Kolegji Civil ka arsyetuar, ndër të tjera, se të dyja gjykatat kanë gabuar në pranimin e padisë së palës paditëse për t’u njohur pronare e truallit bazuar në nenin 175/4 të Kodit Civil (KC), pasi kjo dispozitë nuk është e zbatueshme në rastin në shqyrtim, por në rastet kur posedimi i tokës dhe ngritja e një ndërtese mbi të nga një person i tretë jopronar realizohen në kushtet e mirëbesimit, por jo nëpërmjet një marrëveshjeje të palëve. Në rastin në shqyrtim posedimi me mirëbesim, gëzimi i truallit dhe ndërtimi mbi të janë rrjedhojë e një marrëveshjeje të palëve, bashkëpronarë të truallit, nga njëra anë, dhe palës paditëse, si ndërtuese, nga ana tjetër. Kjo marrëveshje është lidhur për të krijuar pasoja juridike (të drejta dhe detyrime) për palët pjesëmarrëse në të. Këto palë duhet të përcaktojnë natyrën juridike të kësaj marrëveshjeje, të drejtat dhe detyrimet respektive, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes eventuale me mirëkuptim ose në rrugë gjyqësore. U takon vetë palëve të përcaktojnë shkakun juridik dhe objektin e mosmarrëveshjes, si dhe kërkimet e pretendimet e tyre, bazuar në kërkesat e neneve 5, 16, 17, 31 etj. të Kodit të Procedurës Civile (KPC) *(shih vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 7-8)*.

- *Procedurat për kundërshtimin e vendimit të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP)*

8. Në datën 05.10.2007 Kontrolli i Lartë i Shtetit (*KLSH*) ka inspektuar zyrën rajonale të KKKP-së, Tiranë dhe ka konstatuar se vendimet nr. 562, datë 20.05.1996, nr. 705, datë 30.09.1996 dhe nr. 170, datë 30.09.1997 të KKKP-së, Tiranë janë marrë në kundërshtim me ligjin. Për pasojë, bazuar në nenet 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 480, datë 27.11.2007, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtyre vendimeve, kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve është bërë transkriptimi i truallit 700 m², duke e kaluar atë në pasuri të shtetit me nr. 3/31 pasurie, ZK 8210, të regjistruar me nr. 289, datë 11.12.2007 në ZVRPP-në, Tiranë.

9. Kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e lartpërmendur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 7086, datë 25.07.2008, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 480, datë 27.11.2007 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 241, datë 15.02.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin e padisë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2012-1554, datë 28.06.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit.

10. Kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e lartpërmendur të Gjykatës së Lartë në Gjykatë, e cila, me vendimin nr. 26, datë 24.06.2013, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1554, datë 28.06.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, për shkak të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

11. Në rigjykim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-55, datë 22.01.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit, duke arsyetuar se ai nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjë prej rasteve të cituara në nenin 472 të KPC-së.

12. Kërkuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2014-55, datë 22.01.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për të cilën Gjykata, me vendimin nr. 17, datë 10.04.2015, ka vendosur rrëzimin e saj.

- Procedurat për shlyerjen e detyrimeve financiare

13. Në datën 03.10.2003 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi kundër shoqërisë “Murataj” sh.p.k., duke kërkuar shlyerjen prej saj të detyrimit të prapambetur në shumën 42 milionë lekë, ndërsa shoqëria “Murataj” sh.p.k. ka paraqitur

kundërpadi, duke kërkuar detyrimin e kërkuësve t'i kthejnë vlerat e paguara prej saj tej vlerës 50% të realizimit mujor të kësaj shoqërie për vitin 1998, sipas bilancit, si një pagim i padetyruar, në shumën 10.528.461 lekë. Me vendimin nr. 2935, datë 09.06.2004, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. t’u paguajë Arsino Kekezit, Veronika Shanit, Fania Zikos, Meri Ekonomit, Aleksandra Laskut, Ingrid Laskut dhe Bledar Laskut shumën 39.600.000 lekë, ndërsa Eleni Shkurtit shumën 3.100.000 lekë, si dhe rrëzimin e kundërpadisë, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

14. Me vendimin nr. 1049, datë 26.10.2005, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2935, datë 09.06.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 246, datë 06.03.2007, ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me tjetër trup gjykues.

15. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1598, datë 14.12.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 2935, datë 09.06.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. t’u paguajë paditësve të kundërpaditur Arsino Kekezit, Veronika Shanit, Fania Zikos, Meri Ekonomit, Aleksandra Laskut, Ingrid Laskut dhe Bledar Laskut për periudhën shtator 1998 - gusht 2001 shumën 21.600.000 lekë, rrëzimin e padisë së paditëses Eleni Shkurti, si dhe lënien në fuqi të vendimit në lidhje me rrëzimin e kundërpadisë.

16. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë shoqëria “Murataj” sh.p.k. ka paraqitur rekurs, si dhe ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të tij. Me vendimin nr. 37, datë 01.02.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1598, datë 14.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërsa me vendimin nr. 00-2012-423 (36), datë 24.01.2012 ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, për shkak të mospasqyrit të saktë në procesverbalin dhe në vendimin e kësaj gjykate të trashëgimtarëve të Eleni Shkurtit, e cila kishte ndërruar jetë, si dhe me qëllim verifikimin e përfaqësimit në gjyq të paditësve të kundërpaditur Jani Shkurti e Dhimitër Shkurti.

17. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 616, datë 12.03.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 2935, datë 09.06.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. t’u paguajë paditësve të kundërpaditur Kleanthi Kekezi, Rezarta Ngjela (trashëgimtarë të paditëses Arsino Kekezi), Veronika Shani, Fania Ziko, Meri Ekonomi, Aleksandra Lasku, Kostandin Lasku, Ingrid Lasku dhe Bledar Lasku, shumën prej 21.600.000 lekësh, si detyrim për periudhën shtator 1998 – gusht 2001; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërimit për paditësit e kundërpaditur të sipërcituar; rrëzimin e

padisë së paditësve Dhimitër Shkurti, Jani Shkurti (trashëgimtarë të Epaminonda Shkurtit), Donika Shkurti, Roland Shkurti e Leandro Shkurti (trashëgimtarë të paditëses Eleni Shkurti); lënien në fuqi të vendimit lidhur me kundërpadinë.

18. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se me vendimin nr. 480, datë 27.11.2007, drejtori i përgjithshëm i AKKP-së ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 562, datë 20.05.1996, nr. 705, datë 30.09.1996 dhe nr. 170, datë 30.09.1997 të KKKP-së, Tiranë, në favor të subjektit Kostandin Lasku (trashëgimtarëve ligjorë). Sipas saj, nëse do të pranohej logjika se pavlefshmëria absolute e vendimeve të ish-KKKP-së nuk sjell pasoja juridike, ndaj paditësit e kundërpaditur nuk kanë qenë asnjëherë pronarë, për rrjedhojë edhe kontrata e lidhur mes tyre është e pavlefshme, do të duhej të pranohej se të gjitha efektet e kësaj marrëveshjeje janë nul, përfshirë këtu edhe lejen për ndërtimin e karburantit. Gjykata ka konstatuar se marrëdhënia juridike e krijuar mes palëve, për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja, është marrëdhënie detyrimi; palët në kontratë janë ato ndërgjyqëse si ortakë të shoqërisë së thjeshtë, të cilat kanë marrë përsipër të drejta dhe detyrime reciproke, për rrjedhojë çështja duhet të zgjidhet vetëm sa u përket këtyre të drejtave dhe detyrimeve. Po sipas gjykatës, pretendimi lidhur me të drejtën e palës paditëse të kundërpaditur mbi pronësinë e truallit nuk ka lidhje me mosmarrëveshjen e paraqitur për gjykim, natyra e së cilës është juridiko-civile-detyrimi, e lindur për shkak të kontratës së shoqërisë së thjeshtë dhe nuk provohet me asnjë provë pretendimi i palës së paditur kundërpaditëse se pagesat e kryera në favor të paditësve të kundërpaditur, të vërtetuara në gjykim sipas mandatpagesave përkatëse, të jenë parapagim për çmimin e truallit, për shkak të rënies dakord të blerjes së tij nga ankuesi. Fakti i vetëm, i provuar dhe i pranuar nga palët, është lidhja e kontratës së shoqërisë së thjeshtë, sipas neneve 1074 e vijues të KC-së (*shih vendimin nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 10-12*).

19. Ndaj vendimit të lartpërmendur kanë paraqitur rekurs shoqëria “Murataj” sh.p.k. në datën 27.03.2013, e cila ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe kërkesit në datën 11.04.2013. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 11243-01655-00-2014 akti, datë 12.05.2014. Me vendimin nr. 177, datë 27.05.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

20. Në datën 13.07.2021 kërkesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të rekursit të regjistruar me nr. 11243-01655-00-2014 akti, datë 12.05.2014, përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes dhe

shpërblimin e drejtë. Sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë për këtë kërkesë nuk rezulton të ketë ende një vendimmarrje.

21. Për rekursin e palëve, me vendimin nr. 00-2022-3327 (505), datë 23.11.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe revokimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit.

22. Në kërkesën e datës 27.07.2022 drejtuar Gjykatës, kërkuar kanë kërkuar edhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të përfundimit të këtij gjykimi në tërësi dhe të gjyqimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë në veçanti.

- Procedurat për njohjen pronar të shoqërisë “Murataj” sh.p.k.

23. Në datën 17.06.2008 shoqëria “Murataj” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar detyrimin e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Ekonomisë për ta njohur pronarë të një pike karburanti dhe zyrash të ndodhur në Tiranë, rruga “Muhamet Gjollesha”, pranë fabrikës së çokollatave, si dhe detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë për të regjistruar në favor të saj objektin “pikë karburanti dhe zyra” të ndodhur në këtë adresë. Shtetasi Bledar Lasku ka paraqitur kërkesë për t’u përfshirë në cilësinë e ndërhyrësit dytësor në këtë proces (*shih dosjen gjyqësore nr. 9195/1333/453 regjistri themeltar, datë 17.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pjesë e dosjes gjyqësore të kësaj gjykate me nr. 1250 vendimi, datë 22.02.2010, faqet 112-113, 131-132, si dhe faqet 8-13 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

24. Me vendimin nr. 9195 akti, datë 09.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pezullimin e gjyqimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes gjyqësore civile me nr. akti 2854, datë regjistrimi 10.01.2008, me paditës Bledar Laskun e Arsinoi Kekezin, të paditur AKKP-në, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 480, datë 27.11.2007 të AKKP-së. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 9195/1333/453 akti, datë 19.04.2010, gjykata ka vendosur refuzimin e kërkesës së Bledar Lasku për t’u futur si ndërhyrës kryesor në gjykim, duke arsyetuar se aktualisht prona nuk është në pronësi të tij dhe të trashëgimtarëve të tjerë Lasku, por në pronësi të shtetit, për rrjedhojë nuk legjitimohet në kërkimin e tij.

25. Në vijim, me vendimin nr. 453 akti, datë 19.04.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e gjyqimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar Bledar Lasku, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e kërkesës për ndërhyrje dytësore.

26. Me vendimin nr. 569, datë 03.12.2010, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 453 akti, datë 19.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Procedurat për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit (procedurat objekt ankimi kushtetues konkret)

27. Në datën 16.04.2008 kërkesit i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit, si dhe sigurimin e objektit të padisë, caktimin e një administratori dhe vendosjen e sekuestros mbi pikën e karburantit. Me vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010, gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lidhur ndërmjet paditësve Arsinoi Kekezi, Veronika Shani, Meri Konomi, Aleksandra Lasku, Kostandin Lasku, Ingrid Lasku, Bledar Lasku, Epaminonda Shkurti, Jani Shkurti e Dhimitër Shkurti dhe palës së paditur, shoqërisë “Murataj” sh.p.k., si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj.

28. Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se ndonëse pala e paditur ka zhvilluar aktivitetin tregtar, ajo nuk i është përgjigjur palës paditëse, sipas marrëveshjes së bërë, për t’i dhënë pjesën takuese të fitimeve të realizuara nga aktiviteti. Bazuar në faktet dhe dispozitat ligjore në fuqi, gjykata ka konkluduar se në kushtet kur bëhet fjalë për një marrëdhënie kontraktore për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik dhe njëra nga palët nuk ka përmbushur detyrimet e saj, me të drejtë pala paditëse ka kërkuar zgjidhjen e kësaj marrëdhënieje. Ky kërkim i palës paditëse është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, duhet pranuar. Po sipas gjykatës, për sa i përket kerkimit të palës paditëse për lirimin e dorëzimin e sendit, objektit “pikë karburanti, servis e lavazh”, i cili figuron i regjistruar në emër të saj sipas regjistrimit hipotekor nr. 3714, datë 22.10.1998, ky regjistrim, sipas shënimit të bërë në të, është i vlefshëm vetëm për objektin dhe jo për truallin, pasi pronësia për truallin vazhdon të jetë në proces gjyqësor. Lidhur me pronësinë e objektit, gjykata ka vërejtur se edhe ky fakt është gjykuar dhe vendosur nga gjykime të tjera të mëparshme. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 640, datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me kundërpadinë, duke konkluduar se ndonëse objekti “pikë karburanti, servis e lavazh” është regjistruar në emër të palës paditëse Arsionoi Kekezi etj., në fakt ky send është pronë e palës së paditur, shoqërisë “Murataj” sh.p.k. Bazuar në sa më sipër, gjykata ka vlerësuar se kërkitimi i palës paditëse për të detyruar palën e paditur të kthejë sendin “pikë karburanti, servis e lavazh”, nuk mund të pranohet, për të gjitha argumentet që kanë përdorur gjykatat e mëparshme dhe për faktin se, sipas nenit 451/a të KPC-së, përbën gjë të gjykuar (*shih vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqet 5, 6, 8 dhe 9*).

29. Ndaj ankimit të paraqitur nga kërkesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë me këtë ndryshim: prishjen e vendimit për pjesën që është rrëzuar padia e palës paditëse lidhur me dorëzimin e sendit dhe sigurimin e objektit të padisë, duke vendosur pushimin e gjykimit. Sipas gjykatës, qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për pjesën që rrëzon padinë bie ndesh me kërkesat e ligjit, si dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 26.05.2010, pasi, pas zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje midis palëve, pasojat do të zgjidhen drejt vetëm kur të saktësohen në mënyrë të pakundërshtueshme rrethanat e krijimit të saj, duke përcaktuar se çfarë kanë vënë palët në dispozicion të këtij aktiviteti, si para, sende ose shërbime. Vendimi nr. 480, datë 27.11.2007 i drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së, që ka shfuqizuar të tria vendimet e KKKP-së, Tiranë, është i pavlefshëm, pasi është marrë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar. Transferimi i pronësisë së truallit 700 m² nga paditësit te shteti, është i pavlefshëm, çështje edhe kjo e shqyrtuar në shkallë të parë e në apel dhe që është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë. Gjykata ka arritur në konkluzionin se për t'u dhënë zgjidhje të drejtë të gjitha pasojave juridike që rrjedhin nga shpërbërja e kësaj shoqërie me situatën juridike të krijuar pas daljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, gjykimi nuk mund të vazhdojë dhe, si i tillë, sipas nenit 468 të KPC-së, për këtë pjesë, vendimi i gjykatës së rrethit duhet të priset dhe çështja të pushohet (*shih vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 5-6*).

30. Në datën 20.11.2011 kërkuessit kanë ushtruar rekurs. Ndërkohë, me vendimin nr. 2003 akti, datë 29.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010 të kësaj gjykate, të lënë në fuqi me ndryshim me vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

31. Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shoqëria përmbarimore private “JUS”, me urdhrin nr. 676/4 prot., datë 10.02.2016, ka urdhëruar regjistrimin e pronës pikë karburanti, servis, lavazh në pronësi të shoqërisë “Murataj” sh.p.k., pasuri e cila rezulton të jetë regjistruar në emër të kësaj shoqërie me nr. 3/31/ND, vol. 14, faqe 183, ZK 8210, e dokumentuar edhe në urdhrin nr. 882 prot., datë 09.03.2016 të ZVRPP-së, Tiranë (*shih shkresën nr. 4382/1 prot., datë 20.03.2017 të ZVRPP-së, Tiranë*).

32. Për sa i përket rekursit të kërkuessve, me vendimin e ndërmjetëm të datës 09.12.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.11.2021 ka vendosur revokimin e tij dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh. Me vendimin nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

33. Në datën 27.07.2022 kërkesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë sipas objektit, duke kundërshtuar procedurat për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit, si dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për procedurat gjyqësore në lidhje me detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k. Në datën 14.10.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

34. **Kërkuesit** kanë parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se u janë cenuar:

Në procesin për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit

34.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

34.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat kanë shkelur vendimin përfundimtar nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është pranuar se mes tyre dhe shoqërisë “Murataj” sh.p.k. ekziston një marrëveshje kontraktore. Edhe në procedurat në lidhje me detyrimet financiare, shoqëria “Murataj” sh.p.k. ka njohur ekzistencën e shoqërisë së thjeshtë dhe nuk ka pasur pretendime se është pronare e pasurisë. Gjykimi për zgjidhjen e kontratës kishte për qëllim që kërkesit të merrnin pronën e tyre. Me vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rrëzuar gjetjet e Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 dhe ndërkohë që ka pranuar shkeljen e kontratës dhe ka vendosur ta zgjidhë atë, nuk i ka kthyer pronën familjes Lasku, por ka përcaktuar pronare shoqërinë “Murataj” sh.p.k., pa u ngritur një pretendim i tillë nga kjo shoqëri. Këto shkelje nuk janë riparuar nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë.

34.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi përmes pushimit nga gjykata e apelit të gjykimit për kthimin e sendit te pronari dhe lënies në fuqi të vendimit të saj nga Gjykata e Lartë, nuk u është dhënë përgjigje pretendimeve të kërkesve për kthimin e sendit, duke e lënë këtë pjesë të kërimit pa zgjidhje. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre të ngritura në rekurs.

34.1.3. *Parimit të gjyimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykatat kanë bërë pjesë të dosjes gjyqësore vendimin nr. 640, datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë, i cili nuk kishte të bënte me këtë gjykim. Po kështu, gjykata e rrethit është shprehur se në pretendimet përfundimtare shoqëria “Murataj” sh.p.k. ka kërkuar rrëzimin e kërkesëpadisë, ndërkohë që ajo nuk ka qenë prezente në seancën e fundit.

34.1.4. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të sigurisë juridike*, si rrjedhojë e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të mëparshëm të Kolegjit tjetër Civil të saj, që kishte vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë dhe shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen *de plano*, ndërkohë që duhej të shqyrtonte në themel pretendimet e ngritura në rekurs. Shqyrtimi në dhomën e këshillimit dhe mbi bazë të dokumenteve nuk ishte një mundësi e re për të vlerësuar pranueshmërinë e rekursit, i cili ishte vlerësuar nga Kolegji i mëparshëm i Gjykatës së Lartë si i rëndësishëm së kërkuar nga ligji për t’u shqyrtuar në thelb.

34.1.5. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi vendimi nr. 640, datë 20.02.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është depozituar si provë nga asnjëra palë në gjykimin e çështjes nga gjykata e rrethit. Ky vendim është bërë pjesë e dosjes gjyqësore si rrjedhojë e kërkesës së gjyqtarës M.K. për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak të pjesëmarrjes së saj në trupin gjykues që e ka dhënë atë, kërkesë së cilës i është bashkëlidhur edhe ky vendim.

34.1.6. *Parimit të disponibilitetit*, pasi duke arritur në përfundimin se shoqëria “Murataj” sh.p.k. ishte pronare e sendit, gjykata e rrethit ka dhënë një vendim *ultra petitem*. Ky pretendim nuk është ngritur asnjëherë nga shoqëria “Murataj” sh.p.k.

34.1.7. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre. Duke vendosur pushimin e gjykimit, gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për kthimin e sendit, ndërsa Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për raportin mes vendimit nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të saj e vendimeve të gjykatës së rrethit e të gjykatës së apelit, objekt rekursi, si dhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike për këtë shkak.

34.2. *Së drejtës së pronës*, pasi kërkuar janë shpronësuar *de facto*, pa shpërblim. Gjykatat nuk i kanë dhënë zgjidhje çështjes së tyre të pronësisë, duke çuar në humbjen përfundimtare të pronës. Ndërtesa “karburant-servis-lavazh” është

regjistruar në emër të tyre sipas lejes së ndërtimit të vitit 1997, të dhënë nga Bashkia Tiranë, përmes së cilës janë bërë pronarë edhe të saj, krahas truallit përreth 700 m², të regjistruar në ZVRPP-në, Tiranë. Përmes vendimit nr. 480, datë 21.11.2007 të drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së është bërë vetëm çregjistrimi i truallit, i cili është regjistruar në emër të shtetit, ndërsa ndërtesa vazhdon të jetë e regjistruar në emër të tyre. Po kështu, pezullimet e herëpashershme nga Gjykata e Lartë të procesit për detyrimet financiare kanë dëmtuar interesat e tyre, për shkak të pamundësisë së marrjes së fitimeve prej 19 vjetësh. Urdhri i ekzekutimit nr. 2003 akti, datë 29.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar në kundërshtim me nenin 510, shkronja “a”, të KPC-së, pasi vendimi nr. 1250, datë 22.02.2010 i gjykatës së rrethit nuk cakton detyrim për asnjërën nga palët. Procedurat për zgjidhjen e kontratës dhe për marrjen e fitimit nuk kanë qenë efektive në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së.

Në procesin për detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k.

34.3. E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

34.3.1. Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi procedurat për kompensimin e pronës, konfliktin e pronësisë, marrjen e fitimit nga shoqëria e thjeshtë e krijuar mes tyre dhe shoqërisë “Murataj” sh.p.k., si dhe për zgjidhjen e kontratës kanë nisur në vitin 1997 dhe nuk kanë përfunduar ende. Procedura për zgjidhjen e kontratës kërkoi 14 vjet për marrjen e një vendimi. Procesi për detyrimet financiare të rrjedhura nga kontrata e lidhur me shoqërinë “Murataj” sh.p.k. ka nisur në vitin 2003 dhe prej 8 vjetësh është në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë, ndërsa kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga kjo gjykatë nuk është marrë ende në shqyrtim. Autoritetet shqiptare kanë qenë të paafta për t’u dhënë zgjidhje përfundimtare dhe në kohë të arsyeshme kërkesave të tyre për gëzimin e pronës dhe të fitimeve që rridhnin nga kontrata me shoqërinë “Murataj” sh.p.k.

34.3.2. Së drejtës për dëmshpërblim, pasi vonesat e vazhdueshme, si rrjedhojë e gjykimeve dhe rigjykimeve të çështjeve i kanë shkaktuar dëm për të cilin, në zbatim të nenit 399/10 të KPC-së, duhet akorduar dëmshpërblim në vlerën 3.200.000 lekë.

35. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murataj” sh.p.k., ka prapësuar se:

35.1. Kërkuesit nuk legjitimohen në kërkimet e tyre, pasi të drejtat e pretenduara janë shuar me vendime të mëparshme gjyqësore. Po kështu, kërkimi konkret ka mbetur pa objekt, pasi trashëgimtarët Kekezi nuk janë më pronarë të truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti.

Në procesin për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit

35.2. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës *për proces të rregullt ligjor* janë të pabazuara për shkaqet e mëposhtme:

35.2.1. Pretendimet për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* janë të pabazuara, pasi proceset gjyqësore të zhvilluara mes saj dhe familjes Kekezi kanë pasur objekte të ndryshme, kanë qenë të pavarura nga njëra-tjetra dhe në asnjë rast kërkuesit nuk kanë kërkuar bashkimin e këtyre proceseve paralele. Ata nuk kanë parashtruar asnjë argument se si proceset e tjera kanë ndërhyrë në vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, si dhe cilat çështje përbëjnë gjë të gjykuar në lidhje me këtë vendim. Me vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kundërpadisë së trashëgimtarëve Kekezi për kthimin e sendit, çka do të thotë se ata nuk mund të ngrinin më këtë kërkim, pasi përbën gjë të gjykuar.

35.2.2. Kërkuesve nuk u është cenuar *e drejta e aksesit*. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur me të drejtë pushimin e gjykimit për kthimin e sendit, pasi ky kërkim është rrëzuar me vendimin përfundimtar nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë. Kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë ligjërisht një shkelje të tillë.

35.2.3. Pretendimi për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme* është i pabazuar, pasi vendimi nr. 640, datë 20.02.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është përfshirë në vendimin e Gjykatës së Lartë, të paraqitur në proces nga kërkuesit dhe të pranuar si provë nga gjykata. Pretendimet e tyre lidhen me fakte që kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjykatave më të ulëta dhe jo me shkelje procedurale që cenojnë procesin e rregullt ligjor.

35.2.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi kërkuesit janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke iu dhënë mundësia të paraqesin pretendimet e tyre. Shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore në dhomën e

këshillimit është e drejtë e Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 482/1 të KPC-së dhe nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor. Bazuar në nenin 181 të KPC-së, kur trupi gjykues i Gjykatës së Lartë ndryshon, procedura e zhvilluar deri në atë moment për çështjen mund të përsëritet nëse vlerësohet e nevojshme.

35.2.5. Kërkuesit kanë pasur mundësi të paraqesin kërkesa, vërejtje, prova, parashtrime, kundërshtime dhe ankime për çështjen, të cilat janë dëgjuar dhe marrë në shqyrtim nga gjykatat. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* është i pabazuar.

35.2.6. Kërkuesve nuk u është cenuar *standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi gjykata e rrethit e ka arsyetuar çështjen bazuar në provat e paraqitura dhe e ka argumentuar vendimin e saj, pavarësisht se ky vendim nuk kënaq pritshmëritë e kërkuesve. Po kështu, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve në ankim dhe në rekurs.

35.3. Pretendimet e kërkuesve për cenimin e *së drejtës së pronës* janë të pabazuara, pasi trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti i është kthyer sërish shtetit. Në këto kushte, marrëveshja e thjeshtë e lidhur me saj dhe kërkuesve ka rënë, pasi këta të fundit nuk janë më pronarë të këtij trualli, i futur si kapital në këtë shoqëri. Juridikisht një marrëveshje e tillë presupozohet se nuk ka ekzistuar ndonjëherë, pasi aktet mbi bazën e të cilave kërkuesit janë bërë pronarë të kësaj pasurie janë konsideruar si absolutisht të pavlefshme nga gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën. Shoqëria “Murataj” sh.p.k. është bërë pronare e sendit përmes legalizimit dhe jo përmes proceseve gjyqësore. Pas marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës së apelit, përmes të cilit prona i ka kaluar shtetit, ajo ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit dhe leja e legalizimit është dhënë në emër të saj në vitin 2013. Kundërshtimi i ekzekutimit të vendimit nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përbën proces më vete dhe Gjykata e Lartë nuk mund të shprehej për të, pasi ajo gjykon vetëm për objektin e padisë për të cilin është ngritur çështja. Zhveshja e pronësisë së trashëgimtarëve Kekezi nuk është rrjedhojë e vendimeve të kundërshtuara.

Në procesin për detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k.

- 35.4. Pretendimet për cenimin e *standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm* janë të pabazuara, pasi e dëmtuar, si rrjedhojë e gjykimeve të shumta të iniciuara nga trashëgimtarët Kekezi, ka qenë shoqëria “Murataj” sh.p.k. dhe jo kërkuessit. Nga ana tjetër, tejzgjatja e procesit në lidhje me detyrimet monetare në Gjykatën e Lartë ka ardhur si rrjedhojë e reformës në drejtësi.
- 35.5. Pretendimet për *të drejtën për dëmshpërblim*, të cilat kanë të bëjnë me tjetër proces gjyqësor, janë aktualisht në shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar ligjërisht e faktikisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

36. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual ka në objekt dy kërtime: kërkimi i parë, për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, ka të bëjë me procesin për zgjidhjen e kontratës me shoqërinë “Murataj” sh.p.k. dhe kthimin e sendit, ndërsa kërkimi i dytë ka të bëjë me konstatimin e shkeljes së afateve të arsyeshme të gjykimit në procesin për detyrimet financiare të kësaj shoqërie ndaj kërkuessve.

38. Kërkuessit, si bartës së të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në të dyja proceset gjyqësore ndaj të cilave kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjet e parashtruara.

39. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike sherojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në analizë të përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se për sa i përket kërkimit të parë të ankimit kushtetues individual, vendimi nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit. Në këto kushte, në lidhje me këtë proces, vlerësohet se kërkuesit kanë shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përpara se t’i drejtohen Gjykatës.

41. Për sa i takon kërkimit të dytë, Gjykata evidenton se ndonëse objekt i tij është konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në procesin për detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k., në përmbajtje të kërkesës kërkuesit kanë pretenduar tejzgjatjen e gjykimit edhe për proceset e tjera gjyqësore. Pavarësisht se pretendimet për tejzgjatje të gjykimit janë ngritur për të gjitha proceset gjyqësore, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit në procesin e detyrimeve financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k., duke iu drejtuar Gjykatës së Lartë në datën 13.07.2021 me kërkesë për konstatimin e shkeljes të këtij afati dhe përshpejtimin e procedurave. Në kushtet kur për këtë kërkesë nuk ka ende një vendim marrje të Gjykatës së Lartë, bazuar në jurisprudencën e saj në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 39, datë 09.12.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se edhe për këtë kërkim kërkuesit i kanë shteruar mjetet në dispozicion përpara se t’i drejtohen asaj. Nga ana tjetër, në zbatim të nenit 131 të Kushtetutës dhe neneve 399/7-399/10 të KPC-së, Gjykata thekson se pretendimet në lidhje me të drejtën për dëmshpërblim, si rrjedhojë e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues.

42. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për sa i përket kërimit të parë objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 28.03.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 27.07.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në lidhje me kërkimin e dytë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, Gjykata konstaton se shkelja është vazhduese dhe se deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual nuk kishte një vendimmarrje të Gjykatës së Lartë për procesin në lidhje me detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuessit legjitimohen *ratione temporis* në kërkesën e tyre për të dyja kërkimet, sipas objektit.

43. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae* në lidhje me kërkimin e parë për procesin për zgjidhjen e kontratës me shoqërinë “Murataj” sh.p.k. dhe dorëzimin e sendit, kërkuessit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit, parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve, parimit të disponibilitetit, standardit të arsytimit të vendimit, si dhe së drejtës së pronës, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

44. Për sa u përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se ato për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj kanë të bëjnë me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.11.2021 të Gjykatës së Lartë për revokimin e vendimit të gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore dhe gjykimin e saj në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se kërkuessit nuk kanë parashtruar asnjë argument dhe nuk kanë arritur të përcaktojnë në mënyrë konkrete se në cilat të drejta procedurale të tyre ka ndikuar kjo vendimmarrje e ndërmjetme, duke mos arritur të provojnë në nivel kushtetues cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Për më tepër, në datën 21.11.2021 kërkuessit janë informuar për vendimin e revokimit, si dhe për të drejtën e tyre për të paraqitur pretendime me shkrim, të cilat i kanë depozituar në datën 09.12.2021. Në përmbajtje të tyre nuk rezulton që kërkuessit të kenë parashtruar prapësime për kalimin e çështjes për gjykim në dhomën e këshillimit.¹

45. Po kështu, edhe për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe të parimit të barazisë së armëve, Gjykata vlerëson se ato nuk janë

¹ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji.

ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuesit nuk kanë arritur të provojnë cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, në kuptim të testit subjektiv dhe testit objektiv të vlerësimit kushtetues të këtij parimi, si dhe nuk kanë arritur të përcaktojnë, në drejtim të cenimit të parimit të barazisë së armëve, se si përfshirja e vendimit nr. 640, datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në dosjen gjyqësore të çështjes konkrete i ka vënë në pozita të pabarabarta përkundrejt shoqërisë “Murataj” sh.p.k.

46. Duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve të tjera të kërkuesve të parashtruara në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në lidhje me kërkimin e parë objekt i ankimit kushtetues, Gjykata çmon t’i analizojë ato në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit.

47. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae* në lidhje me kërkimin e dytë për procesin për detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k., kërkuesit kanë pretenduar cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm të këtij procesi, pretendim i cili, gjithashtu, përfshihet në juridiksionin kushtetues.

48. Për rrjedhojë, në vijim Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të pretendimeve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit dhe për cenimin e së drejtës së pronës, të cilat kanë të bëjnë me procesin për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit, si dhe të pretendimeve për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në lidhje me procesin për shlyerjen e detyrimeve financiare nga shoqëria “Murataj” sh.p.k.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për objektin e parë të kërkimit për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me procesin për zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit

B.1.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

49. Kërkuesit kanë pretenduar se gjykatat kanë shkelur vendimin përfundimtar nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është pranuar se mes tyre dhe shoqërisë “Murataj” sh.p.k. ekziston një marrëveshje kontraktore. Sipas tyre, edhe në procedurat për detyrimet financiare, shoqëria “Murataj” sh.p.k. ka njohur ekzistencën e shoqërisë së thjeshtë dhe nuk ka pasur pretendime se është pronare e pasurisë. Gjykimi për

zgjidhjen e kontratës kishte për qëllim që kërkuesit të merrnin pronën e tyre. Me vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rrëzuar gjetjet e Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 dhe ndërkohë që ka pranuar shkeljen e kontratës e ka vendosur ta zgjidhë atë, nuk i ka kthyer pronën familjes Lasku, por ka përcaktuar pronar shoqërinë “Murataj” sh.p.k., pa u ngritur një pretendim i tillë nga kjo shoqëri. Përmes pushimit të gjykimit për kthimin e sendit te pronari nga gjykata e apelit dhe lënien në fuqi të tij nga Gjykata e Lartë, gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për kthimin e sendit, duke i lënë ato pa zgjidhje. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për raportin mes vendimit nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të saj e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë e të apelit, objekt rekursi, si dhe për cenimin e parimit të sigurisë juridike për këtë shkak.

50. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murataj” sh.p.k., ka prapësuar se pretendimet e kërkuesve janë haptazi të pabazuara. Sipas këtij subjekti, proceset gjyqësore të zhvilluara mes saj dhe Kekezëve kanë pasur objekte të ndryshme, kanë qenë të pavarura nga njëra-tjetra dhe në asnjë rast kërkuesit nuk kanë kërkuar bashkimin e këtyre proceseve paralele. Ata nuk kanë parashtruar asnjë argument se si proceset e tjera kanë ndërhyrë në vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, si dhe cilat çështje përbëjnë gjë të gjykuar në lidhje me këtë vendim. Me vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kundërpadisë së trashëgimtarëve Kekezi për kthimin e sendit, çka do të thotë se ata nuk mund ta ngrinin më këtë kërkim, pasi përbën gjë të gjykuar. Gjykata e rrethit e ka arsyetuar çështjen bazuar në provat e paraqitura dhe e ka argumentuar vendimin e saj, pavarësisht se ky vendim nuk kënaq pritshmëritë e kërkuesve. Po kështu, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë arsyetuar vendimet e tyre, duke marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve në ankim dhe në rekurs.

51. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si elemente të parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe

siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Po kështu, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësve se gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë nuk qëndrojnë. Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 1250, datë 22.02.2010, është ndalur gjerësisht në vlerësimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, duke paraqitur me referenca edhe pjesë nga arsyetimi i tij, si dhe duke shpjeguar dy konkluzionet e saj: (i) se është i drejtë kërkitimi për zgjidhjen e marrëdhënies kontraktore për ushtrimin e aktivitetit ekonomik, në kushtet kur njëra nga palët nuk ka dhe nuk mund të përmbushë detyrimet e saj; (ii) se kërkitimi i palëve paditëse për të detyruar palën e paditur t'u kthejë pikën “karburant, servis e lavazh” nuk mund të pranohet, për shkak se është gjë e gjykuar në bazë të nenit 451/a të KPC-së. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011, është shprehur se bazuar në provat e shqyrtuara në proces, midis të cilave edhe vendimi nr. 1764, datë 07.10.2004, me të drejtë është arritur në përfundimin se është provuar në mënyrë të pakundërshtueshme ekzistenca e marrëdhënieve juridike në formën e shoqërisë së thjeshtë, të parashikuar nga nenet 1074 e vijues të KC-së. Ndërsa lidhur me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, që ka rrëzuar kërkimin e padisë për kthimin e sendit me

arsyetimin e gjësë së gjykuar, gjykata e apelit ka arsyetuar se duhej ndryshuar, për shkak se duhej zbatuar vendimi nr. 27, datë 26.05.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

54. Po kështu, pretendimet e kërkuessve të parashtruara në rekurs dhe në prapësimet e datës 09.12.2021, se gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë dhe nuk u kanë kthyer objektin e regjistruar në emër të tyre, kanë gjetur pasqyrim në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë objekt i ankimit kushtetues (*shih vendimin nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 7-8, paragrafi 27*) e janë marrë në shqyrtim në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila, në përfundim të gjykimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së dhe se gjatë procesit të zhvilluar nga gjykatat e ulëta nuk ka pasur shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit.

55. Për sa më lart, Gjykata konstaton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim dhe kanë disponuar nëpërmjet vendimmarrjes vlerësimin e tyre lidhur me pretendimet e kërkuessve, përfshirë edhe ato të parashtruara në drejtim të parimit të sigurisë juridike, duke dhënë përgjigje të argumentuara për vendimet e marra, në drejtim të ligjit të zbatueshëm, interpretimit të tij, qëndrimeve të mëparshme të gjykatave në proceset e ndryshme të iniciuara në lidhje me këtë pasuri, përfshirë edhe ato të Gjykatës. Nga shqyrtimi i vendimeve nuk rezulton që interpretimi i ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes të ketë qenë arbitrar, me pasojë cenimin e parimit të sigurisë juridike në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, vendimet e gjykatave paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente, të plota dhe pa kundërthënie, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsyetimit.

56. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuessve për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.²

57. Në vijim, Gjykata vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuessit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese, në kushtet kur nuk gjeti cenim të parimit të sigurisë juridike në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit, Gjykata vlerëson se edhe pretendimet e kërkuessve për cenimin e së drejtës së pronës janë të pabazuara.

² Vendosën për rrëzimin e pretendimit të cenimit të parimit të sigurisë juridike në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqtarët Holta Zaçaj, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim.

Vendosën për pranimin e pretendimit të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqtaret Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Marjana Semini.

B.2. Për objektin e dytë të kërimit lidhur me konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në procesin për detyrimet financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k.

58. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuessit kanë pretenduar se procesi për detyrimet financiare të rrjedhura nga kontrata e lidhur me shoqërinë “Murataj” sh.p.k. ka nisur në vitin 2003 dhe është prej 8 vjetësh në pritje për t’u gjykuar nga Gjykata e Lartë, ndërsa kërkesa e tyre për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga kjo gjykatë nuk është marrë ende në shqyrtim. Në vijim, në parashtrimet e datës 25.11.2022 për çështjen, ata kanë informuar Gjykatën se Gjykata e Lartë ka vendosur për çështjen e themelit me vendimin nr. 00-2022-3327 (505), datë 23.11.2022.

59. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murataj” sh.p.k., ka prapësuar se pretendimet e kërkuessve për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm janë të pabazuara, pasi e dëmtuar, si rrjedhojë e gjykimeve të shumta të inciuara nga trashëgimtarët Kekezi ,ka qenë ajo dhe jo kërkuessit. Nga ana tjetër, sipas saj, tejzgjatja e procesit në lidhje me detyrimet monetare në Gjykatën e Lartë ka ardhur si rrjedhojë e reformës në drejtësi.

60. Gjykata vëren se në datën 11.04.2013 kërkuessit kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili është regjistruar në atë gjykatë me nr. 11243-01655-00-2014 të regjistrimit themeltar, datë 12.05.2014, ndërsa në datën 13.07.2021 i janë drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, si rrjedhojë e mosshqyrtimit të rekursit brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së.

61. Sipas vendimit nr. 00-2022-3327 (505), datë 23.11.2022, rezulton se për themelin e çështjes Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe revokimin e vendimit të tij nr. 177, datë 27.05.2014 për pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, ndërsa për sa i takon kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton që ajo të jetë shqyrtuar ende.

62. Pavarësisht se Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim çështjen e themelit, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuessve për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit në atë gjykatë përfshihet në juridiksionin kushtetues, pasi tejzgjatja mbi 9 vjet e 7 muaj e gjykimit të rekursit mbetet pretendimi thelbësor i kërkuessve. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të analizojë bazueshmërinë në themel të kërkesës së tyre për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, si rrjedhojë e tejzgjatjes së gjykimit të rekursit, pavarësisht faktit se kjo gjykatë tashmë e ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkuessve.

B.2.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

63. Kërkuesit kanë pretenduar se u është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi deri në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual çështja e tyre ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, pavarësisht se kishin kaluar mbi 8 vjet nga data e regjistrimit të saj në këtë gjykatë, në shkelje të nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

64. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murataj” sh.p.k., ka prapësuar se tejzgjatja e procesit në Gjykatën e Lartë ka ardhur si rrjedhojë e reformës në drejtësi.

65. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se në datën 03.10.2003 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi kundër shoqërisë “Murataj” sh.p.k. për shlyerjen prej saj të detyrimit të prapambetur. Me vendimin nr. 2935, datë 09.06.2004, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e shoqërisë t’u paguajë kërkuesve shumat respektive. Vendimi i kësaj gjykate është prishur me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim me tjetër trup gjykues, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit është prishur me vendimin nr. 246, datë 06.03.2007 të Gjykatës së Lartë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit. Edhe vendimi i datës 14.12.2007 i gjykatës së apelit, i marrë pas rigjykimit të çështjes, është prishur sërish me vendimin nr. 36, datë 24.01.2012 të Gjykatës së Lartë, e cila e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, me vendimin nr. 616, datë 12.03.2013, gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, detyrimin e shoqërisë “Murataj” sh.p.k. t’u paguajë kërkuesve shumat e përcaktuara në vendim, rrëzimin e padisë për një pjesë të kërimit, rrëzimin e padisë së disa prej kërkuesve, si dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit për kundërpadinë.

67. Në vijim, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs në datën 11.04.2013. Çështja është regjistruar në këtë gjykatë në datën 12.05.2014 me nr. 11243-

01655-00-2014 të regjistrit themeltar dhe është marrë në shqyrtim në datën 23.11.2022, pra pas 9 vjetësh, 7 muajsh e 13 ditësh nga depozitimi i rekursit. Në përfundim të gjykimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe revokimin e vendimit të tij nr. 177, datë 27.05.2014, përmes të cilit është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit.

68. Lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve civile, Gjykata vëren se me ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ligjvënësi ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, që zgjatet edhe me 1 vit e 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109 i ligjit nr. 38/2017).

69. Kërkuesit kanë pretenduar se në gjykimin e çështjes nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Duke konsideruar afatet ligjore në rastin konkret, Gjykata vlerëson se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë i ka tejkaluar ato, ndaj çështja do të analizohet në vijim sipas kritereve të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese.

70. Konkretisht, në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 34, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të vlerësuar kohëzgjatjen e gjykimit nga Gjykata e Lartë në rastin konkret dhe nëse kërkuesve u është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, këto kritere do të analizohen në vijim.

i. Sjellja e kërkuesve

71. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

72. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesit kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Në datën 13.07.2021 i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se sjellja e kërkuesve nuk është bërë shkak për vonesat në shqyrtimin e çështjes së tyre.

ii. Kompleksiteti i çështjes

73. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

74. Në rastin konkret, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, që rregullohet nga KC-ja dhe KPC-ja. Ajo ka pasur për objekt një kërkim të vetëm, konkretisht atë të detyrimit të shoqërisë “Murataj” sh.p.k. për pagimin e detyrimeve financiare. Në aspekt të numrit të palëve në proces, i cili, gjithashtu, analizohet për të vlerësuar kompleksitetin e çështjes, Gjykata konstaton se si palë në gjykimin në shkallë të parë ka qenë, krahas kërkuesve, edhe shoqëria “Murataj” sh.p.k. Procedurat në tërësi, deri në datën 11.04.2013 të paraqitjes së rekursit kundër vendimit nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kanë zgjatur rreth 10 vjet e 6 muaj, ndërsa procedura e shqyrtimit të rekursit ndaj këtij vendimi ka zgjatur mbi 9 vjet e 7 muaj.

75. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ndonëse në dukje çështja në tërësi duket komplekse, për shkak të numrit të proceseve gjyqësore të zhvilluara, e parë e shkëputur nga proceset e tjera, çështja objekt i këtij shqyrtimi kushtetues nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat në gjykimin në Gjykatën e Lartë prej 9 vjetësh, 7 muajsh e 13 ditësh.

iii. Sjellja e autoriteteve

76. Kërkuesit kanë pretenduar se autoritetet shqiptare kanë qenë të paafta për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare dhe në kohë të arsyeshme kërkesave të tyre për gëzimin e pronës dhe të fitimeve që rridhnin nga kontrata me shoqërinë “Murataj” sh.p.k.

77. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murataj” sh.p.k., ka prapësuar se tejzgjatja e procesit në Gjykatën e Lartë ka ardhur si rrjedhojë e reformës në drejtësi.

78. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Në jurisprudencën e saj në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të tillë. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Gjykata rithekson se efektet e reformës në drejtësi nuk përbëjnë argument kushtetues në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave dhe evidenton se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, pavarësisht se KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2023; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

81. Edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballlet me ngarkesë si rezultat i zbatimit të reformës në drejtësi, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose të justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuesve. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se gjykimi i rekurseve të paraqitura nga palët në gjykim ka vazhduar për më se 9

vjet e 7 muaj pa vendimmarrje, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC. Duke pasur parasysh faktin se çështja ka të bëjë me përcaktimin e detyrimeve financiare të shoqërisë “Murataj” sh.p.k. kundrejt kërkuessve, të cilat përfshihen në konceptin e së drejtës së pronës, Gjykata vlerëson se në rastin e kërkuessve sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke shkaktuar vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së tyre.

iv. Çfarë përbën rrezik për interesin e kërkuessit

82. Kriteri “*interesi i kërkuessit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të*” përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Sipas jurisprudencës kushtetuese disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuessit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuessin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të së drejtës/interesit të kërkuessit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti.

83. Sipas Gjykatës, në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 11.05.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

84. Në jurisprudencën e saj mbi nenin 41 të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se koncepti kushtetues i pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, përfshin edhe detyrimet e ndryshme, për sa kohë bëhet fjalë për pagesën e një sasive të caktuar të hollash që merret nga pasuria e individit (*shih vendimet nr. 30, datë 02.11.2022; nr. 15, datë 22.06.2022; nr. 11, datë 21.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës, vlerëson se kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore ka vënë në rrezik një interes të rëndësishëm të kërkuessve.

85. Nga sa më lart, në përmbledhje të analizës së kriterëve kushtetues të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, Gjykata çmon se ndonëse me vendimin nr. 00-2022-3327 (505), datë 23.11.2022, të marrë gjatë gjykimit të ankimit kushtetues individual konkret,

Gjykata e Lartë ka vendosur për çështjen e themelit, kërkesve u është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe se përmes vendimmarrjes së saj Gjykata e Lartë u ka kaluar atyre barrën e reformës në drejtësi. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të pranohet.³

86. Në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vendosur tashmë për rekursin e kërkesve në lidhje me themelin e çështjes dhe gjykimi për këtë proces ka përfunduar, Gjykata vëren se rasti konkret nuk kërkon qëndrim të saj në lidhje me përshpejtimin e gjykit nga Gjykata e Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, regjistruar me nr. 11243-01655-00-2014 të regjistrimit themeltar të Gjykatës së Lartë.
3. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.05.2023

Shpallur më 27.06.2023

³ Votuan për pranimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Marjana Semini. Votuan për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm gjyqtarët Holta Zaçaj, Elsa Toska dhe Genti Ibrahim, me arsyetimin se interesat e kërkesve nuk cenohen nga tejzgjatja e procesit, mbështetur në të njëjtat argumente si ato në Mendimin e Pakicës të vendimit nr. 25, datë 11.05.2023 të Gjykatës.

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Shpresa Kekezin dhe të tjerë, si dhe objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2139, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afateve të arsyeshme të gjykimit në procedurën e zgjidhur deri më sot me vendimin nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Urdhërimi për kryerjen e pagesave sipas këtij vendimi. Rivendosja e së drejtës së pronësisë për shpronësimin e pësuar nga kërkuarët. Shpërblimi i kërkuarëve për shkeljen e afateve të arsyeshme të gjykimeve”, ne, gjyqtarët në pakicë, kemi votuar për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pasi ky vendim nuk plotëson standardin e arsyetimit të një vendimi gjyqësor në kuptimin kushtetues.

2. Sikundër është evidentuar edhe nga shumica, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Sipas Gjykatës, vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërtënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (shih vendimet nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

3. Nga ana tjetër, po sipas jurisprudencës kushtetuese, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet

nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në rastin konkret, që është objekt i ankimit kushtetues individual, rezulton se në kërkesëpadinë drejtuar gjykatës së rrethit kërkuar zgjidhjen e kontratës dhe dorëzimin e sendit nga shoqëria “Murataj” sh.p.k. Me vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesëpadisë, zgjidhja e mosmarrëveshjes së lindur mes tyre dhe shoqërisë “Murataj” sh.p.k., si dhe rrëzimi i kërkesëpadisë për pjesën tjetër, konkretisht për dorëzimin e sendit, objekt ndërtimor. Në analizë të kësaj vendimmarrjeje rezulton se gjykata ka arsyetuar se, sipas vendimit nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë, ndonëse objekti ndërtimor ishte regjistruar në emër të kërkuarve, pronësia për të i përkiste shoqërisë “Murataj” sh.p.k. (*shih vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, faqja 9*). Ndërkohë, me vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është vendosur, në thelb, rrëzimi i kërtimeve të të dyja palëve kundërshtare, është arsyetuar se kërkuar nuk mund të kërkonin kthimin e ndërtesës, pasi ajo ishte në bashkëpronësi me shoqërinë “Murataj” sh.p.k. dhe me të njëjtin arsyetim edhe kjo e fundit nuk mund të kërkonte njohjen e pronësisë, pasi ishte bashkëpronare në ndërtim. Po sipas arsyetimit të këtij vendimi të Gjykatës së Lartë, palët duhej të zgjidhnin në rrugë gjyqësore mosmarrëveshjen e pronësisë së objektit ndërtimor (*shih vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqja 8*). Në analizë të këtyre vendimmarrjeve, konstatojmë se ka një lloj mospërputhjeje mes arsyetimit të dhënë në vendimin nr. 1250, datë 22.02.2010 të gjykatës së rrethit, për sa i përket mënyrës së interpretimit të vendimit nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë dhe përmbajtjes së këtij vendimi, i cili, në thelb, ka orientuar palët për ndjekjen e rrugës gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

5. Në vijim, vendimi nr. 1250, datë 22.02.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ankimuar nga kërkuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011, ka vendosur pushimin e çështjes në lidhje me kërkimin për kthimin e sendit, me arsyetimin se pas daljes së vendimit nr. 27, datë 26.05.2010 të Gjykatës, që ka gjetur kompetencën e drejtorit të përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizim të vendimeve të KKP-ve në cenim të sigurisë juridike, për t’u dhënë zgjidhje të drejtë pasojave juridike që rridhnin nga shpërbërja e shoqërisë, gjykimi nuk mund të vazhdonte dhe çështja duhej të pushohej (*shih vendimin nr. 2139, datë 20.10.2011 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqja 6*).

6. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se vendimi i pushimit të gjykimit, në vetvete, nuk përbën mohim aksesit, pasi është një nga mënyrat e disponimit të gjykatës, megjithatë në

rastin konkret konstatojmë se argumentet e dhëna nga gjykata e apelit për pushimin e gjykimit lidhen me vendimin e Gjykatës, ndërkohë që ka mbetur pa përgjigje kërkitimi i kërkuësve për kthimin e sendit. Në këtë drejtim, sjellim në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës, e cila në disa raste ka vlerësuar se pushimi i gjykimit nga gjykatat e zakonshme cenon të drejtën për akses substancial, pasi e drejta e kërkuësit për të marrë përgjigje përfundimtare nga gjykata për pretendimet e ngritura nuk realizohet (*shih vendimet nr. 7, datë 21.02.2023; nr. 2, datë 29.01.2016; nr. 22 datë 16.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga ana tjetër, në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuësit kanë parashtruar, ndër të tjera, edhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit*, pasi duke vendosur pushimin e gjykimit, gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për kthimin e sendit (*shih vendimin nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 7-8, paragrafi 27*). Këto pretendime janë të njëjta me ato të parashtruara edhe në ankimin kushtetues individual, në të cilin, në drejtim të cenimit të këtij standardi, kërkuësit kanë pretenduar konkretisht se gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit për kthimin e sendit, ndërsa Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për raportin mes vendimit nr. 1764, datë 07.10.2004 të Kolegjit Civil të saj e vendimeve të gjykatës së rrethit e të gjykatës së apelit, objekt rekursi, si dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike për këtë shkak (*shih paragrafin 34.1.7. të vendimit të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në analizë të vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjen, kjo gjykatë ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në ligj; gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato; se vendimi i saj nuk është në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk vihen re shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit (*shih vendimin nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, paragrafët 37 dhe 38*).

9. Ndërkohë, në vendimmarrjen për çështjen shumica ka vlerësuar: “Pretendimet e kërkuësve të parashtruara në rekurs dhe në prapësimet e datës 09.12.2021, se gjykatat e faktit nuk kanë marrë parasysh vendimin nr. 1764, datë 07.10.2004 të Gjykatës së Lartë dhe nuk u kanë kthyer objektin e regjistruar në emër të tyre, kanë gjetur pasqyrim në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë objekt ankimi kushtetues [...] e janë marrë në shqyrtim në vijim nga Gjykata e Lartë, e cila, në përfundim të gjykimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se ai ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që

parashikohen në nenin 472 të KPC-së dhe se gjatë procesit të zhvilluar nga gjykatat e ulëta nuk ka pasur shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurave të gjykimit. Në këndvështrim të analizës së vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, objekt i ankimit kushtetues individual, Gjykata konstaton se gjykatat kanë marrë në shqyrtim dhe kanë disponuar nëpërmjet vendimmarrjes vlerësimin e tyre lidhur me pretendimet e kërkuësve, përfshirë edhe ato të parashtruara në drejtim të parimit të sigurisë juridike, duke dhënë përgjigje të argumentuara për vendimet e marra, në drejtim të ligjit të zbatueshëm, interpretimit të tij, qëndrimeve të mëparshme të gjykatave në proceset e ndryshme të iniciuara në lidhje me këtë pasuri, përfshirë edhe ato të Gjykatës. Nga shqyrtimi i vendimeve nuk rezulton që interpretimi i ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes të ketë qenë arbitrar, me pasojë cenimin e parimit të sigurisë juridike në kuptimin kushtetues. Nga ana tjetër, vendimet e gjykatave paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente, të plota dhe pa kundërthënie, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsytimit (*shih paragrafët 54 dhe 55 të vendimit*).

10. Duke iu referuar analizës së shumicës në vendim, rezulton se ajo nuk i është përmbajtur standardit të arsytimit sipas jurisprudencës kushtetuese, i cili analizohet rast pas rasti, sipas kontekstit të çdo çështjeje dhe kurdoherë, gjatë kontrollit kushtetues, arsyetimi i gjykatave të zakonshme duhet të kalojë testin kryesor, atë të dhënies përgjigje për shqetësimin kryesor të kërkuësve. Në rastin konkret, konstatojmë se pavarësisht pretendimeve të ngritura nga kërkuësit në lidhje me pushimin nga gjykata e apelit, të gjykimit për kthimin e sendit, arsyetimi i Gjykatës së Lartë është ai standard, i përdorur prej saj në çdo rast që pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me vlerësimin e provave ose interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat më të ulëta, duke mos arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e kërkuësve nga pikëpamja kushtetuese dhe duke mos i dhënë përgjigje juridike konkrete dhe të drejtpërdrejtë asaj që është kërkuar. Në këtë kuptim, në vlerësimin tonë, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

11. Po kështu, edhe sipas parimit të subsidiaritetit, Gjykata e Lartë ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve me natyrë kushtetuese dhe në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që

udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të vihet në lëvizje për ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në vështrim të situatës dhe fakteve të mësipërme, pretendimi i kërkuësve, për të cilin nuk është dhënë përgjigje nga gjykatat e zakonshme mbi objektin ndërtimor (karburant-servis-pikë lavazhi) dhe që është ngritur si pretendim edhe para Gjykatës së Lartë, nuk ka gjetur analizë në vendimin e kësaj të fundit, objekt kundërshtimi. Pra, kërkuësit edhe pse e kanë ushtruar të drejtën për ta bërë objekt konflikti gjyqësor çështjen e pronësisë së objektit ndërtimor, në fakt nuk kanë marrë një përgjigje të qartë dhe shteruese për kërkimin e tyre, pasi nga ana e gjykatës së apelit për faktin se kujt i përket pronësia e ndërtimit “të objektit karburant-servis-pikë lavazhi”, gjykimi është pushuar. Në rastin konkret, arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë, se gjykata e apelit ka respektuar ligjin procedural dhe atë material, duke i interpretuar dhe zbatuar drejt ato, nuk rezulton të jetë i qartë dhe as i mjaftueshëm në kontekstin kushtetues.

13. Nisur nga arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në çështjen konkrete, në respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, dhe në mënyrë specifike të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me pritshmëritë e kërkuësve për një përgjigje përfundimtare mbi thelbin e kërimit të tyre, vlerësojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e vendosura për arsyetimin e vendimit gjyqësor.

14. Për sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor ndaj dhe duhej shfuqizuar.

Anëtare: Marjana Semini, Sonila Bejtja, Elsa Toska

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkuessve Shpresa Kekezi, Teri Kekezi, Bledar Lasku, Donika Shkurti, Roland Shkurti dhe Leandro Shkurti, me objekt “Shfuqizimi i vendimeve nr. 1250, datë 22.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2139, datë 20.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afateve të arsyeshme të gjykimit në procedurën e zgjidhur deri më sot me vendimin nr. 616, datë 12.03.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Urdhërimi për kryerjen e pagesave sipas këtij vendimi. Rivendosja e së drejtës së pronësisë për shpronësimin e pësuar nga kërkuessit. Shpërblimi i kërkuessve për shkeljen e afateve të arsyeshme të gjykimeve”, ne gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji, edhe pse bashkohemi me qëndrimin e shumicës për pretendimet e shqyrtuara në themel, ndajmë mendim të ndryshëm për (mos)legjitimitimin e kërkuessve për pretendimin e cenimit të gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të sigurisë juridike.

2. Në ngritjen e këtij pretendimi, kërkuessit kanë parashtruar si shkak vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë, me të cilin është revokuar vendimi i mëparshëm për shqyrtimin e çështjes së tyre në seancë gjyqësore. Sipas kërkuessve, Gjykata e Lartë e ka gjykuar çështjen *de plano* dhe ka vendosur mospranimin e rekursit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte në themel pretendimet e ngritura në rekurs. Shqyrtimi në dhomë këshillimi edhe një herë i shkaqeve të rekursit nuk ishte një mundësi e re, pasi ishte zhvilluar më parë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

3. Subjekti i interesuar ka prapësuar se ky pretendim nuk qëndron, pasi shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore ose në dhomë këshillimi është e drejtë e Gjykatës së Lartë bazuar në KPC dhe nuk përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor. Sipas tyre, kur përbërja e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë ndryshon, procedura e zhvilluar deri në atë moment për çështjen mund të përsëritet nëse vlerësohet e nevojshme.

4. Shumica ka arsyetuar se lidhur me këtë pretendim kërkuessit nuk kanë parashtruar asnjë argument dhe nuk kanë arritur të përcaktojnë në mënyrë konkrete se në cilat të drejta procedurale të tyre ka ndikuar kjo vendimmarrje e ndërmjetme, duke mos arritur të provojnë në nivel kushtetues cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Sipas shumicës, në datën 21.11.2021 kërkuessit janë informuar për vendimin e revokimit, si dhe për të drejtën e tyre për të paraqitur pretendime me shkrim, të cilat i kanë depozituar në datën 09.12.2021, dhe në

përmbajtje të tyre nuk rezulton që ata të kenë parashtruar prapësime për kalimin e çështjes për gjykim në dhomën e këshillimit (*shih paragrafin 44 të vendimit*).

5. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se argumentet e parashtruara nga kërkuesit janë të mjaftueshme, ndaj pretendimi i tyre gjen mbështetje në faktet e çështjes dhe në standardet kushtetuese të parimit të gjykatës së caktuar me ligj të lidhur me parimin e sigurisë juridike.

6. Gjykata ka pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në jurisprudencën e Gjykatës, në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është bërë ndarja e qartë mes juridiksionit dhe kompetencave të dhomës së këshillimit dhe asaj të seancës (*shih vendimin nr. 17, datë 18.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Kështu, si në lidhje me shqyrtimin e rekursit ose të kërkesës për rishikim, Gjykata është shprehur për rolin që ka dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e tyre, ajo luan rolin e një filtri për kërkesat që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 26, datë 27.03.2017; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Para hyrjes në fuqi të ndryshimeve në KPC me ligjet nr. 38/2017 dhe nr. 44/2021, në dhomën e këshillimit verifikohej vetëm legjitimiteti i kërkuesit, bazueshmëria në ligj e rekursit, si dhe prania e kriterëve ligjore për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa gjatë gjykimit të çështjes në seancë gjyqësore shqyrtohej bazueshmëria e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, pra themeli i çështjes. Ndërkohë që me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të lartpërmendura, kompetencat e dhomës së këshillimit kanë pësuar rregullime të reja, pasi në

të mund të shqyrtohet tashmë edhe themeli i shkaqeve të ngritura në rekurs (nenet 482, 482/a dhe 485 të KPC-së).

9. Në këtë pikëpamje, për të vlerësuar respektimin e gjykatës së caktuar me ligj në drejtim të procedurës dhe kompetencave, në rastin e kolegjeve të Gjykatës së Lartë është e rëndësishme të evidentohet se shqyrtimi i rekursit ndjek dy faza procedurale të ndryshme, në të cilat kompetencat e kolegjeve janë të ndryshme: (i) faza e shqyrtimit paraprak, procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomë dhe kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi lidhen me seleksionimin e rekurseve të suksesshme; (ii) faza e shqyrtimit të themelit të shkaqeve të rekursit, procedurë e cila sipas natyrës së çështjes dhe në diskrecion të Kolegjit të Gjykatës së Lartë mund të zhvillohet në dhomën e këshillimit ose në seancë me pjesëmarrjen e palëve, ku kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë lidhen me themelin e shkaqeve të rekursit rreth çështjeve të kuptimit të ligjit, sipas hipotezave të detajuara në ligjet procedurale.

10. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, rezulton se me vendimin e ndërmjetëm të datës 09.12.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërsa me vendimin e ndërmjetëm të datës 11.11.2021 ka vendosur revokimin e tij dhe shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit. Në përfundim, me vendimin nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Shkaku që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur revokimin e vendimit është hyrja në fuqi e ndryshimeve të reja ligjore në KPC në datën 29.05.2021 - 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 71, datë 14.05.2021, pra pas dhënies së vendimit të parë të ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

11. Siç ka theksuar Gjykata, në të drejtën procedurale vepron parimi *tempus regit processum*, sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se efekti prapaveprues i ligjit procedural është përjashtim që vendoset nga ligjvënësi sipas kriterëve specifike, me qëllim që të mos ndikojë në mënyrë arbitrare në të drejtat tashmë të fituara nga të tretët.

12. Në këtë kuptim, duhet vënë re se, si rregull, fillimi i procesit gjyqësor gjeneron tek individit një lloj të drejte të fituar për të ruajtur të paprekura rregullat procedurale në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës. Zbatimi i këtij parimi duhet bërë sipas një *modus procedendi* të caktuar, në mënyrë që veprimtaria procedurale e kryer të mos “shqetësohet” nga rregullimet e reja, përndryshe uniteti dhe konsistenca e veprimtarisë procedurale të kryer sipas ligjit të kohës do të vihej në pikëpyetje në mënyrë të pashmangshme. Thënë ndryshe, duke qenë

se procesi është një lloj procedure, pra një sekuencë e normave juridike të koordinuara për prodhimin e një akti përfundimtar, parimi në fjalë nuk mund të udhëheqë dhënien e vendimit përfundimtar, por secilin prej akteve procedurale që duhet të formësohet sipas ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së tij.

13. Në këtë këndvështrim, duke qenë se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë zhvillohet në disa faza të ndryshme, me karakteristika që dallojnë nga njëra-tjetra, vlerësojmë se ndryshimet ligjore të natyrës procedurale që miratohen gjatë procesit gjyqësor, në përmbajtje të cilave nuk ka asnjë rregull për efekte prapavepruese, mund të rregullojnë vetëm efektet e paezauruara të tij dhe nuk mund të zbatohen për marrëdhëniet tashmë të rregulluara sipas ligjit të kohës. Në vlerësimin tonë, një qëndrim i ndryshëm do të binte ndesh me parimet që mbrohen nga Kushtetuta, të tilla, si siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme të individëve nga rendi juridik në tërësi, si dhe nga rregullat procedurale në veçanti, të cilat, bazuar në garancitë e procesit të rregullt ligjor, kërkojnë që gjatë zbatimit të akteve ligjore të mos lihet vend për arbitraritet. Në këtë kuptim, parimi *tempus regit processum* përjashton efektin prapaveprues të ligjit të ri dhe, për pasojë, rivlerësimin e aktit të kryer sipas ligjit të kohës nën dritën e rregullave të reja.

14. Nisur nga sa më lart, bazuar në parimin *iura novit curia*, jemi të mendimit se pretendimet e kërkuësve për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj duhej të analizoheshin jo vetëm në drejtim të parimit të sigurisë juridike, por edhe të së drejtës së ankimit.

15. Gjykata e Lartë në vendimin objekt shqyrtimi ka arsyetuar se referuar ndryshimeve në KPC, por edhe rregullave që përcaktohen në legjislacionin procedural mbi revokimin e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, për rastin në gjykim vlerësohet se është e domosdoshme që shqyrtimi i kësaj çështjeje të bëhet në dhomë këshillimi. Sipas saj, në respektim të rregullave që kërkon zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor dhe për t'u dhënë mundësi palëve për të realizuar mbrojtjen e tyre, mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, duhet të bëhet njoftimi i tyre për të depozituar në një kohë sa më të shpejtë parashtrimet me shkrim, me qëllim zhvillimin e një gjykimi kontradiktor (*shih paragrafin 31 të vendimit nr. 00-2022-759, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Lartë*). Pavarësisht këtij arsyetimi, vlerësojmë se parimet e sigurisë juridike dhe të pritshmërive legjitime, për aspekte procedurale që lidhen me të drejta kushtetuese dhe ligjore, subjektive të palëve në proces, sikurse është e drejta e ankimit, nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte në rastin konkret, për shkak të efektit prapaveprues që u janë dhënë rregullimeve të reja ligjore, edhe pse një gjë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj.

16. Bazuar në standardet e lartpërmendura, vlerësojmë se nëse dhoma e këshillimit e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë sipas ligjit të kohës ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs duhet të shqyrtohen në seancë gjyqësore dhe të marrin përgjigje të arsyetuar, ky vendim i ndërmjetëm nuk mund të rivlerësohej duke i dhënë fuqi prapavepruese ligjit të ri procedural.

17. Në vlerësimin tonë, vendimet e dhomës së këshillimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore nuk mund të barazohen me vendimet e ndërmjetme procedurale, të cilat jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'u përgjigjen kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat procedurale. Kjo për arsye se vendimet e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbyllin një fazë të procedurës që zhvillohet në atë gjykatë, duke ia kaluar çështjen për shqyrtim një tjetër trupi gjyqësor, me kompetenca të ndryshme, i cili e shqyrton tashmë çështjen në themel dhe duhet të shprehet me vendim përfundimtar për bazueshmërinë e pretendimeve.

18. Në këto kushte, vendimi i Gjykatës së Lartë shfaq probleme me natyrë kushtetuese, të cilat duhet të kishin marrë një vlerësim përfundimtar konkret edhe në themel, kjo pasi, së pari, Gjykata e Lartë ka interpretuar me efekt prapaveprues parashikimet e reja procedurale, duke zbatuar ndryshimet ligjore gjatë fazave procedurale të ndryshme të procesit ligjor dhe pasi çështja në fjalë ishte shqyrtuar tashmë në dhomën e këshillimit nga një tjetër kolegji i po asaj gjykate, i cili, pasi kishte ezauruar fazën e shqyrtimit paraprak të shkaqeve të ngritura në rekurs, kishte vendosur kalimin e saj në seancë gjyqësore. Së dyti, Gjykata e Lartë ka vlerësuar arsyet dhe shkaqet për të cilat dhoma e këshillimit e mëparshme e asaj gjykate kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke hamendësuar dhe prezumuar për mënyrën se si ajo ka vepruar, ndërkohë që shkaqet për të cilat pranohet për shqyrtim rekursi janë përcaktuar nga dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin në Gjykatën e Lartë. Të tilla vlerësime që i përkasin shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit nuk mund t'i nënshtrohen më vlerësimit nga një trupë e ndryshme, as për arsye të ndryshimit të legjislacionit procedural që nuk parashikon efekte prapavepruese dhe as për arsye të ndryshimit të përbërjes së asaj gjykate/trupave të saj. Së treti, në kushtet kur ligji procedural që është interpretuar dhe zbatuar nga Gjykata e Lartë nuk parashikon shprehimisht të drejtën e kolegjit për të revokuar vendime të mëparshme, duhej analizuar nëse dhënia e efekteve prapavepruese të rregullave të reja procedurale përbën interpretim arbitrar të ligjit nga ajo gjykatë, në kuptim të (mos) respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 42 të Kushtetutës.

19. Nisur edhe nga parimet e rëndësishme që mund të cenohen nga një praktikë e tillë e Gjykatës së Lartë, jemi të mendimit se lidhur me këtë çështje duhej të jepej një vlerësim përfundimtar konkret dhe në themel, kjo edhe për të orientuar veprimtarinë procedurale të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në drejtim të respektimit të të drejtave kushtetuese të individit.

20. Në përfundim, vlerësojmë se kërkesit legjitimohen në ngritjen e këtij pretendimi dhe nëse Gjykata do të kishte analizuar bazueshmërinë në themel të tij, ai duhet të ishte pranuar.

Anëtare: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari